



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.37, datë 20/07/2005

**“MBI SPOSTIMIN E MURIT TË NDËRMARRJES METALIKE “TIRANA”
PËR SHKAK TË ZGJERIMIT TË RRUGËS SË DURRËSIT”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 10, pika 3/1, gërma “c”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.378, dt.12/08/1999 “Për kalimin e të drejtës së përfaqësuesit të pronarit për disa objekte pronë publike, organeve të qeverisjes vendore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.153, dt.03/04/1993 “Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore”, pika 2, gërma “ç”, Vendimit të K.RR.T-së Nr.75, dt.17/09/2004 “Për miratim të projektit teknik”, që parashikon zgjerimin e rrugës së Durrësit në të dy anët e saj, kërkuar nga Drejtoria e Projekteve të Infrastrukturës, pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Kalimin kapital të sipërfaqes së truallit prej 775 m² nga Ndërmarrja Metalike “Tirana” në Ndërmarrjen Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit, me qëllim realizimin e projektit për rikonstrukcionin të rrugës së Durrësit dhe prishjen e murit rrethues.
2. Në zbatim të likës 1 të këtij Vendimi, të bëhet heqja nga kontabiliteti i Ndërmarrjes Metalike “Tirana” e godinës së rojes me vlerë 5000 lekë.
3. Të bëhet azhurnimi i genplanit të ri nga Ndërmarrja Metalike “Tirana”.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Urbanistikës, Drejtoria Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit dhe Ndërmarrja Metalike “Tirana”.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI